

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7972  
E shtunë, 18 janar 2025  
Çmimi 0.50 €

Nënshkruhet  
marrëveshja 86 milionë  
euro për renovimin e  
ndërtesave publike | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



## FLUTURA KUSARI, JURISTE E MEDIAS: KOMPLETOHET KAPJA POLITIKE E KPM-së



Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM) ka miratuar të premten ndryshimet në rregullore, ku Besnik Berisha është zgjedhur kryetar i ri. Ndaj këtij emërimi ka reaguar juristja e medias, Flutura Kusari, e cila ka theksuar se kapja politike e

KPM-së u kompletua. Sipas saj, rregullorja e re u ndryshua kundërligjshëm dhe ka kryetar jolegjitim. "Ky është sulm politik ndaj pavarësisë së Komisionit të Pavarur për Media dhe është bërë për të ushtruar presion në

televizione", ka theksuar Kusari. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka theksuar se votimin e së premtes e sheh si përpjekje të hapur për politizimin dhe instrumentalizimin e KPM-së për interesa të partisë në pushtet

### AKTUALE



**PRESIDENTI BIDEN LEHTËSON MASËN E DËNIMIT PËR RRETH 2 500 PERSONA** F. 2

**SHQIPËRIA I JEP DRITËN E GJELBËR DHËNDRIT TË TRUMPIT: CILI ËSHTË PLANI PËR SAZANIN?** F. 6

**PKD-JA BËN THIRRJE TË SHMANGET GJUHA NXITËSE DHE FYESE NË FUSHATËN ZGJEDHORE** F. 7

### EKONOMI



**ATK-ja 25 VJET PUNË, MBI 11 MILIARDË EURO REZULTAT** F. 7

**KOSOVA INVESTON NË KONKURRUESHMËRI DHE KONEKTIVITET ME MBËSHTETJEN E BANKËS BOTËRORE** F. 7

### SPORT



**SUPERLIGA VAZHDON PËRBALLJET INTERESANTE** F. 10



**EDHE SA MUND TA SHPËRFILLË KURTI PROKURORINË SPECIALE?** F. 3

**ZYRTARËT SHTETËRORE TAKOJNË DELEGACIONIN E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË KIE-SË, FLASIN PËR ZGJEDHJET DHE PROCESIN E ANËTARËSIMIT** F. 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Ish-kryeministri pakistanez dënohet me 14 vjet burgim për korrupsion

ISLAMABAD, 17 JANAR - Një gjykatë në Pakistan e dënoi ish-kryeministrin e vendit, që tashmë gjendet në burg, Imran Khan, me 14 vjet burgim, ndërkaq gruan e tij me shtatë, pasi i gjeti fajtorë për korrupsion, thanë zyrtarët dhe avokatët e tij. Pas vendimit, në llogarinë në "X" të Khanit u tha se ai kurrë nuk do të pranojë "këtë diktaturë". "Unë do të qëndroj në burg për aq kohë sa të jetë e nevojshme në luftën kundër kësaj diktature, por kurrë nuk do të bëj kompromis me parimet e mia dhe luftën për liri të vërtetë të kombit". Ai, po ashtu, tha se gruaja e tij u dënua "vetëm për të më bërë presion mua dhe për të më lënduar mua".

Çifti është akuzuar se kur Khan ishte në pushtet, ka pranuar dhuratë një tokë nga një pasanik i patundshmërive në

këmbim të pastrimit të parave. Prokurorët thanë se biznesmeni Malik Riaz më pas u lejua nga Khan që të paguante gjoba që i ishin vendosur për një rast tjetër me të njëjtat para të pastruara prej 190 paundësh britanikë (240 milionë dollarë). Këto para u kthyen në Pakistan nga autoritetet britanike më 2022 për t'u depozituar në thesarin e shtetit.

Khan i ka mohuar akuzat dhe ka insistuar se që nga arrestimi i tij më 2023 të gjitha akuzat kundër tij janë komplot nga rivalët që ta mbajnë larg garimit për post shtetëror.

Khan, që u bë kryeministër më 2018, u rrëzua nga pushteti përmes një mocioni mosbesimi në Parlament prillin e vitit 2022. Khan, 72 vjeç, përballat me më shumë se 150 raste penale, edhe pse ai gëzon popullaritet të madh në mesin e



pakistanezëve. Ai dhe partia e tij politike, Pakistan Tehrik-e Insaf (PTI), kanë thënë se këto raste janë të motivuara politikisht.

Vendimi Khanit iu shqiptua në gjykatën në burgun në Ravalpindi, ku po vuan dënimin.

Mediet lokale raportuan se bashkëshortja e tij, Bushra Bibi, u dërgua në paraburgim pak pas shqiptimit të dënimit, pasi ajo gjendej në lirim me kusht.

Avokati i Khanit, Faisal Chaudhry, tha se dënimi do të apelohej, teksa ligjvënësit nga PTI-ja u mblodhën jashtë

Parlamentit, duke thënë se ish-kryeministri ishte ndëshkuar padrejtësisht.

Përmes një deklaratë, PTI-ja tha se rasti kundër Khanit dhe bashkëshortes së saj "ka mungesë të një baze të fortë dhe është i destinuar të dështojë".

Disa nga mbështetësit e Khanit u mblodhën jashtë burgut Adaila në Ravalpindi, brohoritën slogane kundër qeverisë dhe kërkuan lirimin e ish-kryeministrit.

Më herët ish-kryeministri është dënuar për akuza për korrupsion, zbulim të sekreteve shtetërore dhe shkelje të ligjeve të martesës dhe në tri vendime të ndara, ai është dënuar me dhjetë, 14 dhe shtatë vjet, respektivisht.

Sipas ligjit në Pakistan, ai duhet t'i vuajë të gjitha dënimet, që do të thotë kohëzgjatja e burgimit do të jetë më e gjatë.

## Presidenti Biden lehtëson masën e dënimit për rreth 2 500 persona

WASHINGTON, 17 JANAR - Presidenti Joe Biden njoftoi të premten vendimin për uljen e masës së dënimit për thuhet 2 500 persona të cilët ishin dënuar për vepra jo të dhunshme që kishin të bëni me drogën. Me këtë vendim, Joe Biden bëhet presidenti që ka nënshkruar më shumë falje dhe lehtësim dënimi sesa çdo president tjetër i Shteteve të Bashkuara.

Presidenti është shprehur se me këto akte synon ta korrigjojë pabarazinë e masës së dënimit, pasi individët përfitues "do të kishin marrë dënime më të shkurtra nëse akuzoheshin sipas ligjeve, politikave dhe praktikave të sotme". "Ky veprim është një hap i rëndësishëm drejt korrigjimit të gabimeve historike, korrigjimit të pabarazive në dënime dhe



ofrimin e mundësisë që individët të kthehen në familjet dhe komunitetet e tyre pasi kanë kaluar shumë kohë pas hekurave", tha Bideni.

Shtëpia e Bardhë nuk i bëri publike emrat e atyre që do të

marrin zbritje të masës së dënimit.

Presidenti Biden njoftoi se mund të ketë edhe vendime për akte të tjera lehtësimi të masës së dënimit, duke premtuar se do ta përdorë kohën përpara inaugurimit të

Trumpit të hënën "që ta shqyrtojë mundësinë për të tjera falje dhe zbritje të dënimit". Kjo mund të përfshijë falje për zyrtarë dhe aleatë për të cilët Shtëpia e Bardhë druhet se mund bëhen padrejtësisht objektiva të administratës së re.

Muajin e kaluar presidenti në largim fali 39 persona të dënuar për krime jo të dhunshme dhe ua uli dënimet rreth 1 500 të tjerëve. Për nga numri, këto vendime ishin më të mëdhatë të ndërmarra në një ditë të vetme.

Po në dhjetor, presidenti Joe Biden lehtësoi dënimet për 37 nga 40 personat e dënuar me vdekje nga gjykatat federale, duke ua ulur dënimin në burgim të përjetshëm. Së fundmi, Bideni fali djalin, Hunter Biden, i dënuar mbi akuza federale për armë dhe

mospagim taksash.

Presidentët zakonisht nënshkruajnë një seri faljesh në fund të mandatit të tyre. Pak para mesnatës, në natën e fundit të mandatit të tij të parë, republikani Trump nënshkroi një sërë faljesh dhe uljesh dënimi për më shumë se 140 persona, duke përfshirë ish-aleatin e tij kryesor, Steve Bannon, reperët Lil Wayne dhe Kodak Black dhe ish-anëtarë të Kongresit.

Akti i fundit i Trumpit si president në mandatin e tij të parë ishte falja për Al Pirron, ish-bashkëshorti i gazetares së kanalit "Fox News", Jeanine Pirro, një nga mbrojtësit e tij më të vendosur. Al Pirro ishte shpallur fajtor për akuza për komplot dhe evazion fiskal dhe ishte dënuar me më shumë se dy vjet burg në vitin 2000.

## Bosnja do të lidhet me rrjetin e gazit të Kroacisë

SARAJEVË, 17 JANAR - Deputetët e Bosnjë-Hercegovinës votuan që ta lidhin rrjetin e gazit të shtetit me atë të Kroacisë, pasi ky shtet ishte nën presion nga Shtetet e Bashkuara që t'i japë fund varësisë energjetike që ka nga Rusia.

Bosnja është krejtësisht e varur nga gazi rus, të cilin e merr përmes gazsjellësit Rrjedha Turke - i vetmi gazsjellës funksional që bart gazin rus për në Evropë dhe përmes interkoneksionit me Serbinë, në lindje të shtetit.

Ambasada amerikane në Sarajevë mirëpriti vendimin e ligjvënësve në Bosnjë. "Ky është një moment i rëndësishëm për Bosnjë-Hercegovinën dhe për ShBA-në. Është një mundësi për të adresuar një shqetësim të sigurisë kombëtare për të dyja vendet: Varësia e Bosnjës nga gazi rus", tha Ambasada Amerikane përmes një njoftimi pak para votimit. "ShBA-ja nuk dëshiron që asnjë nga miqtë e saj dhe partnerët në Evropë t'i ekspozohen shantazhit të mundshëm rus dhe këtu bën



pjesë edhe Bosnjë-Hercegovina", u shtua në njoftim.

Bosnja, që ka një popullsi prej 3.5 milionë banorësh, kishte konsumuar 225 milionë metra

kubik gaz më 2023.

Veç të tjerash, projekti do ta lidhë sistemin e gazit të Bosnjës me terminalin e gazit të lëngshëm natyror në ishull Krk të Kroacisë.

Projekti, po ashtu, përfshin ndërtimin e një gazsjellësi prej 180 kilometrash, nga të cilët 160 kilometra do të ishin në Bosnjë. Vlera e ndërtimit të këtij tubacioni llogaritet të jetë rreth 200 milionë euro.

Ndërtimi i tij është debatuar për vite të tëra dhe partia kryesore boshnjake-kroate ka kërkuar që ajo të ndërtohet nga një kompani e re, që do të dominohej nga komuniteti kroat. Por, projekti do të menaxhohet nga një kompani ekzistuese publike.



# Edhe sa mund ta shpërfillë Kurti Prokurorinë Speciale?



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është ftuar dy herë nga Prokuroria Speciale që të dëshmojë për një rast në lidhje me rezervat shtetërore, por nuk ka pranuar të paraqitet para këtij organi. Kurti i ka ftuar prokurorët ta intervistojnë në zyrën e tij që, sipas njohësve, është praktikë e kundërligjshme. A ka ndonjë afat kohor që përcakton se sa mund ta presë Prokuroria kryeministrin Kurti që të dëshmojë?

PRISHTINË, 17 JANAR - Muajin e kaluar Prokuroria Speciale e ftoi kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime me rezervat shtetërore. Por dy ftesave të Prokurorisë kreu i ekzekutivit iu përgjigj me një kërkesë: prokurorët të shkojnë dhe ta intervistojnë në zyrën e tij, në Kryeministri. As Prokuroria Speciale e as Qeveria e Kosovës nuk u janë përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë nëse palët kanë rënë dakord për një datë për dëshmimin e kryeministrin. Ndonëse që nga ftesa e parë ka kaluar më shumë se një muaj, njohësit e fushës së drejtësisë thonë se nuk ka një afat të caktuar kohor se sa mund ta presë Prokuroria kryeministrin Kurti që të dëshmojë. Viona Bunjaku, hulumtuuese ligjore në Lëvizjen FOL, thotë

për Radion Evropa e Lirë se, pavarësisht se nuk ka një afat ligjor, Kurti duhet ta japë dëshminë e tij sa më shpejt. "Në parimet e Kodit [të Procedurës Penale] është i mishëruar parimi i ekonomizimit të procedurës, që nënkupton se duhet të ndodhë sa më parë, e në të njëjtën kohë Prokuroria është e lidhur me afatin e hetimit, i cili është dy vjet. Por, në këtë rast, kjo duhet bërë sa më parë", shprehet ajo. Ndërkaq, Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi, thotë se në çdo rast Prokuroria duhet ta ruajë integritetin e hetimeve dhe të veprojë në bazë të ligjit dhe ndaj dëshmitarit të marrë masa që parashihen me Kodin e Procedurës Penale. Sipas tij, "nëse prokurorët nuk kanë guxim profesional", atëherë jo vetëm kryeministri, por edhe qytetarët e zakonshëm "mund të tallen dhe të mos e respektojnë autoritetin e

Prokurorisë". Se sa mund të zgjasë e gjithë kjo situatë, varet nga ajo se kur ka marrë Prokuroria vendim për nisjen e hetimeve, dhe më pas nga kjo ndikohet edhe afati ligjor kur prokurori i rastit duhet të marrë vendim për hedhjen poshtë të kallëzimit penal apo ngritjen e ndonjë aktakuze, shpjegon Miftaraj. "Sidoqoftë, prokurori në asnjë rrethanë nuk duhet të lejojë që dëshmitari të bëjë obstrukcione në administrimin e procedurës penale, por duhet të ndërmarrë veprime procedurale për ta zbardhur të vërtetën lidhur me rastin që ka në punë", thotë ai.

## Çfarë thotë ligji për mosparaqitjen e dëshmitarëve?

Në Kodin e Procedurës Penale thuhet se një gjyqtar, sipas detyrës zyrtare, apo me kërkesë të Prokurorit të Shtetit, mund ta detyrojë një dëshmitar që të paraqitet. Nëse ai nuk paraqitet në Prokurori, gjyqtari e dënon atë me gjobë prej 250 eurosh sa herë që ai refuzon. Por, nëse ka refuzim edhe pas shqiptimit të gjobave, ai mund të burgoset, por jo më shumë se një muaj. Më 16 dhjetor 2024 Kurti nuk shkoi në Prokurorinë Speciale, e cila tha se ai gjendej në një udhëtim jashtë vendit. Zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, deklaroi për REL-in se Kurti "ka shprehur gatishmërinë

t'i mirëpresë prokurorët e rastit në zyrën e tij në një ditë dhe orë të dakorduar nga të dyja palët për ta përmbushur kërkesën e dalë nga ftesa e Prokurorisë". Katër ditë më vonë u bë me dije se Kurtit i është dërguar një ftesë e re.

## Përplasja e ekzekutivit me gjyqësorin

Çështja e ftesës për Kurtin ka përplasur everinë me Prokurorinë. Ministra e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, deklaroi se pajtohet me kryeministrin se e gjithë kjo gjoja ishte planifikuar nga kryeprokurori i Shtetit, Blerim Isufaj, që të bëhet lajm "në media vendore e ndërkombëtare, që Kurti paska qenë i ftuar për një aferë korruptive". Haxhiu tha se, në të kaluarën, zyrtarë të lartë qeveritarë – pa përmendur emra – janë intervistuar në ambiente të Qeverisë. Por, Isufaj tha se në pesë vjetët sa ai ka qenë në pozitë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

## Intervistimi në zyrë, "i kundërligjshëm"

Kërkesa e Kurtit që të intervistohet në zyrë, sipas Viona Bunjakut, është e gabuar dhe nuk është "praktikë e shëndoshë", pasi duhet të synohet të ndërtohet një sistem i

shtetit të së drejtës, mbi praktika "të mirëqena, dhe jo duke bërë veprime të kundërligjshme". Refuzimi nga cilido zyrtar shtetëror që të paraqitet në Prokurori, sipas saj, është praktikë e rrezikshme, që në "një mënyrë apo tjetrën cenon sigurinë juridike" dhe krijon "precedent të një revolte ndaj institucionit ndjekës". Edhe Ehat Miftaraj pajtohet se, nëse bëhet përjashtim për Kurtin që ta japë dëshminë në zyrën e tij, kjo do të ishte në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe me rastet "kur dëshmitari ose i pandehuri mund të merren në pyetje në vende jashtë zyrave të Prokurorisë".

## Rasti i rezervave shtetërore

Më 2023 tre persona u arrestuan për rastin e rezervave shtetërore. Në mesin e tyre ishin edhe punonjës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), që udhëhiqet nga Rozeta Hajdari, e cila, gjatë paraqitjes për dëshmi në Prokurorinë Speciale, ka zgjedhur të mbrohet në heshtje. Në këtë ministri më 2023 u kryen bastisje pas publikimit të audioincizimeve nga portali "Nacionale", ku pretendohet se një sasi vaji, e blerë në Poloni, dhe një sasi gruri, e blerë në Turqi, nuk kishin arritur kurrë. Qeveria ka thënë se pagesat për rezervat shtetërore ishin bërë në përputhje me ligjin.





# Flutura Kusari, juriste e medias: Kompletohet kapja politike e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM) ka miratuar të premtën ndryshimet në rregullore, ku Besnik Berisha është zgjedhur kryetar i ri. Ndaj këtij emërimi ka reaguar juristja e medias, Flutura Kusari, e cila ka theksuar se kapja politike e KPM-së u kompletua. Sipas saj, rregullorja e re u ndryshua kundërligjshëm dhe ka kryetar jolegjitim. “Ky është sulm politik ndaj pavarësisë së Komisionit të Pavarur për Media dhe është bërë për të ushtruar presion në televizione”, ka theksuar Kusari. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka theksuar se votimin e së premtës e sheh si përpjekje të hapur për politizimin dhe instrumentalizimin e KPM-së për interesa të partisë në pushtet

Mehmeti deklaruar se “ai asnjëherë nuk i ka ikur përgjegjësisë, jemi në mbledhjen e rregullt, dhe ky nuk është institucion që unë e marrë me veti”. Megjithatë, pro ndryshimit të rregullores votuan tre anëtarë.

Pas ndryshimit të rregullores, anëtarët votuan për zgjedhjen e kryetarit të ri, ku me katër vota për u zgjodh Besnik Berisha. “Më katër vota për Besnik Berisha zgjedhet kryetar. Ju falënderoj për praninë. Kërkoj ta vazhdoni punën si institucion shumë i rëndësishëm, ku vendimet që merren prekin mediet dhe qytetarët, dhe të jeni transparentë maksimalë”, theksoi Mehmeti.

Anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media, po ashtu, kanë demantuar raportimet në

rrjete sociale, KPM ka planifikuar ta shkarkojë kryetarin e KPM-së, duke thënë se janë të rreme dhe propagandë. Ndërsa kanë thënë se ditëve në vijim do të marrin masa për këtë.

Ndaj këtij emërimi ka reaguar juristja e medias, Flutura Kusari. “Kapja politike e KPM-së u kompletua. Siç ju paralajmërova: 1. Rregullorja e re u ndryshua kundërligjshëm; 2. Jeton Mehmeti u shkarkua De Facto nga pozita e kryetarit të KPM-së; 3. KPM tash ka kryetar jolegjitim. Ky është sulm politik ndaj pavarësisë së Komisionit të Pavarur për Media dhe është bërë për të ushtruar presion në televizione. Ne punën tonë e kryem, e dokumentuam kapjen politike nga pushteti të KPM-

së”, ka shkruar Kusari në “Facebook”.

## AGK-ja e shqetësuar me procesin e zgjedhjes së kryetarit të ri të KPM-së

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka përcjellë me shqetësim mbledhjen e Komisionit të Pavarur të Medieve, në të cilën është votuar një kryetar i ri, disa ditë para skadimit të mandatit të kryetarit aktual, Jeton Mehmeti.

Zgjedhja e Besnik Berishës për kryetar të KPM-së ngre pikëpyetje ligjore për mënyrën e ndryshimit të Rregullores së KPM-së, e cila parasheh që kryetari i ri zgjidhet në mbledhjen e parë pasi t'i ketë skaduar mandati ose të jetë shkarkuar kryetari aktual.

AGK-ja e sheh votimin e së premtës si përpjekje të hapur për politizimin dhe instrumentalizimin e KPM-së për interesa të partisë në pushtet, duke u bazuar në qëndrimet publike të iniciatorëve për ndryshimet aktuale.

Komisioni i Pavarur i Medieve, si organ kushtetues, luan rol të rëndësishëm në rregullimin e skenës mediale në Kosovë dhe, si i tillë, duhet ta ruajë pavarësinë e plotë dhe të mos lejojë ndërhyrjet politike.

**EPOKA  
ERE**

Lirim GECI

**PRISHTINË, 17 JANAR** - Komisioni i Pavarur i Medieve në mbledhjen e mbajtur të premtën ka miratuar plotësim/ndryshimin e rregullores së brendshme, e që përfshin zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit të ri, para se t'i skadojë mandati kryetarit aktual.

Kryetari i KPM-së, Jeton Mehmeti, ka thënë se ndryshimi i rregullores kërkon diskutim publik, por që kjo u kundërshtua nga anëtarët të cilët deklaruan se kjo është çështje e brendshme dhe se nuk

ka arsye për diskutim. “Unë nuk jam dakord me asnjërin prej tyre. Ndryshimi i rregullores kërkon diskutim publik. Duhet të respektohet ky nen i Ligjit të KPM-së. Nuk pajtohem edhe me të dytën... zgjedhja e kryetarit duhet të bëhet në seancën vijuese dhe argumenti se mund të mbetemi pa kryetar nënkupton se anëtarë më i vjetër është përfaqësues i KPM-së. Kjo deri në konstituimin e një organi të ri të anëtarëve të rinj dhe sikurse ishte më herët kur të vijnë anëtarët e ri dhe siç thotë rregullorja me 2/3 zgjidhet nënkryetari dhe kryetari i ri”, ka thënë Mehmeti. Po ashtu,





## IKShPK-ja: Rasti me LijënM është liruar nga Klinika Infektive

PRISHTINË, 17 JANAR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se rasti i parë i importuar i LijësM (Mpox) dhe të gjitha kontaktet e ngushta të tij e kanë përfunduar periudhën e izolimit dhe të monitorimit, duke iu kthyer normalitetit. "Siç është

informuar më parë, IKShPK me datë 26 dhjetor 2024 kishte detektuar një rast me LijënM. Me datë 16 janar 2025 janë bërë 21 ditë nga konfirmimi i këtij rasti dhe prej asaj dite nuk është raportuar apo konfirmuar asnjë rast tjetër i LijësM në Kosovë. Rasti me LijënM

është liruar nga Klinika Infektive ditë më parë në gjendje të mirë shëndetësore dhe me rekomandimet shtesë për kujdes dhe sjellje shëndetësore, ndërkohë që te asnjë prej kontakteve të identifikuar të rastit, nuk ka pasur manifestim të

shenjave të dyshimta për infeksion dhe që të gjitha i janë kthyer normalitetit pas periudhës së monitorimit të rregullt nga IKShPK", bëhet me dije në njoftimin për medie, duke theksuar se IKShPK-ja vazhdon ta monitorojë në mënyrë të vazhdueshme situatën



epidemiologjike lidhur me Mpox dhe për sëmundjet e tjera ngjitëse në vend.

# Zyrtarët shtetërorë takojnë delegacionin e Asamblesë Parlamentare të KiE-së, flasin për zgjedhjet dhe procesin e anëtarësimit

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në takim një delegacion të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, kryesuar nga Petra Bayr, i cili do t'i vëzhgojë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 9 shkurtit.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen për mbështetjen e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) ndaj institucioneve të Kosovës dhe mirëpriti angazhimin e këtij misioni i cili për herë të parë do t'i monitorojë zgjedhjet në Kosovë.

Në takim u theksua se zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 janë zgjedhjet e para të rregullta që do të mbahen në përputhje me Ligjin e ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndaj presidentja vlerësoi këtë çast si një hap i rëndësishëm në përmirësimin e proceseve demokratike në vend. Presidentja Osmani nënvizoi nevojën për një fokus të veçantë në përfaqësimin e grave në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, sikurse edhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke siguruar qasje të plotë dhe të barabartë në qendrat e votimit.

Më tej, presidentja Osmani ka potencuar se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për t'u anëtarësuar në Këshillin e

Evropës, ndaj do të vazhdojë ta fuqizojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premten në takim delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të kryesuar nga Petra Bayr.

Pasi i falënderoi për vizitën e tyre në Kosovë, kryetari Konjufca i njoftoi mysafirët me ecurinë aktuale politike në vendin tonë, në këtë periudhë të fushatës zgjedhore që përfundon me zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, duke vlerësuar se ky proces është duke u zhvilluar konform përcaktimit të tij ligjor, në frymë demokratike, si dhe duke i ndjekur e nxitur vlerat tona të përbashkëta evropiane.

Në takim u diskutua rreth ligjit të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës që e definojnë këtë proces, si dhe në lidhje me pritshmëritë që këto zgjedhje ta vazhdojnë traditën e mirë demokratike, si një vend që aspirojmë zhvillim sa më të madh në këtë drejtim, me aspirata të anëtarësimit në strukturat ndërkombëtare dhe evropiane. Po ashtu, kryekuvendari Konjufca ritheksoi se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës, ashtu siç ka qenë dhe vijon të mbetet e angazhuar në ruajtjen dhe zhvillimin e



mëtejshëm të demokracisë në vendin tonë, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

Kryetari Konjufca e falënderoi delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për diskutimin e frytshëm dhe i uroi qëndrim sa më të mirë e sa më produktiv në vendin tonë.

Edhe Kurti ka pritur në takim

ekipe të misionëve vëzhgues të zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Përgjatë këtyre takimeve u diskutua rreth procesit zgjedhor e zgjedhjeve të 9 shkurtit si dhe rëndësisë së mbarëvajtjes së tyre. Kryeministri Kurti theksoi se procesi duhet të jetë transparent dhe demokratik.

U konstatua se Kosova ka arritur ta realizojë shumicën e rekomandimeve të partnerëve tanë ndërkombëtarë në lidhje me procesin zgjedhor, gjersa vendi ynë vijon të jetë shtet i pluralizmit politik dhe i garës së hapur e të drejtë për të gjithë.

Kryeministri Kurti i falënderoi ekipet e misionëve vëzhgues për takimin e bisedën e sotme si dhe angazhimin e tyre.

## Trembëdhjetë persona marrin trajtim mjekësor pas zjarrit në Prishtinë



PRISHTINË, 17 JANAR - Autoritetet policore thanë se rreth orës 18:40 pranuan informatën se një ndërtesë banimi në kryeqytetin e Kosovës ishte përfshirë nga zjarri.

Zyrtarët policorë dhe zjarrfikësit dolën në vendngjarje, duke evakuuar banorët dhe duke luftuar me flakët. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, shprehu mirënjohje për ekipet e zjarrfikësve, policisë dhe ekipet mjekësore për "reagimin e shpejtë dhe profesionalizmin e lartë shpëtuan jetën e qytetarëve". "Do të vazhdojmë të

qëndrojmë pranë qytetarëve dhe të sigurohemi që ndihma dhe mbështetja e nevojshme të jenë të garantuara për të gjithë ata që janë prekur nga kjo fatkeqësi", tha ai.

Në një deklaratë dhënë nga vendi i ngjarjes, Rama tha se ka dëme materiale, duke shtuar se dy makina janë djegur dhe tri të tjera janë dëmtuar.

Policia tha se për hollësi të tjera për këtë ngjarje, opinioni do të njoftohet pas përfundimit të ekzaminimeve dhe hetimeve nga institucionet kompetente.



## Portugalia dërgon 29 ushtarë në Kosovë për të siguruar stabilitet gjatë zgjedhjeve të 9 shkurtit

PRISHTINË, 17 JANAR - Njëzet e nëntë pjesëtarë të Gardës Republikane Kombëtare (GNR) të Portugalisë do të nisen sot (e premte) për në Kosovë për t'iu bashkuar një force rezervë ndërkombëtare, të komanduar nga një major portugez, i cili synon të ndihmojë në sigurimin e stabilitetit gjatë zgjedhjeve parlamentare në vend.

Misioni zgjatë maksimalisht gjashtë muaj dhe ceremonia e nisjes është zhvilluar të premten në Njësinë e Ndërhyrjes GNR, në Pontinha

(Odivelas), me praninë e komandantit të përgjithshëm të institucionit, Rui Veloso, ministres së Administratës së Brendshme, Margarida Blasco, dhe sekretarit të shtetit për administratën e brendshme, Telmo Correia. "Ushtarët e këtij kontingjenti do të dinë të nderojnë emrin e Portugalisë, duke thënë se ne jemi një vend i madh në vlera dhe i madh në kauzat që mbrojmë", ka siguruar Rui Veloso, duke theksuar se misioni që tani fillon në Kosovë është "një mundësi që Portugalia të



afirmojë në terren përkushtimin e saj ndaj idealeve të lirisë".

Ministrja Blasco ka shprehur "besimin e plotë në suksesin e

misionit dhe në lartësimin e emrit të Portugalisë përtej kufijve".

Forca rezervë, e quajtur Njësia e Policisë së Formuar të

Rezervuar (RFPU), e Xhandarmerisë Evropiane (Eurogendfor) do të veprojë brenda kornizës së misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë - EULEX Kosovë.

Sipas GNR-së, RFPU përbëhet nga 29 ushtarë të institucionit portugez, 22 nga Xhandarmëria Kombëtare Franceze, 24 nga karabinierët italianë dhe nëntë nga Viesojo Saugumo Tarnyba, forcat speciale lituaneze.

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë janë caktuar për 9 shkurt.

## Shqipëria i jep dritën e gjelbër dhëndrit të Trumpit: Cili është plani për Sazanin?

TIRANË, 17 JANAR - Qeveria e Shqipërisë i ka dhënë statusin e investitorit strategjik kompanisë së dhëndrit të Donald Trumpit, Jared Kushner, për të ndërtuar një resor luksoz në ishullin e Sazanit, që aktualisht është bazë ushtarake. Komiteti për Investime Strategjike, që udhëhiqet nga kryeministri shqiptar Edi Rama, më 30 dhjetor ka pranuar propozimin e kompanisë Atlantic Incubation Partners LLC, për projektin prej 45 hektarësh në ishullin e Sazanit. Projekti parasheh një investim prej 1.4 miliard eurosh.

Në vendimin e shkruar, që u bë publik më 15 janar, Komiteti tha se projekti ishte në përputhje me ligjet për investime strategjike dhe përmbushi numrin e vendeve të punës që kërkohen me ligj, duke thënë se në të vlerësohet se do të punësohen 1 000 persona. Sipas ligjit, dhënia e statusit të investitorit strategjik lejon kompaninë që ta zbatojë projektin që vlerësohet strategjik në një sektor të ekonomisë, siç është turizmi. Po ashtu, ky status do të bëjë që projekti "të përfitojë nga procedurat e përsheptuara dhe përfitime të tjera".

Statusi i investitorit strategjik kompanisë së Kushnerit i është dhënë për periudhën 10-

vjeçare. "Forma e pjesëmarrjes së shtetit në këtë investim do të realizohet përmes krijimit të një entiteti të përbashkët ligjor", tha Komiteti, duke shtuar se në projekt do të përfshihet Korporata Shtetërore e Investimeve Shqiptare.

Tani qeveria shqiptare tha se do të punojë me partnerët amerikanë për ta pastruar zonën nga çdo municion i mundshëm i mbetur në tokë dhe për të adresuar çdo shqetësim tjetër mjedisor dhe ligjor para se projekti të vazhdojë.

Shqipëria tha se ka të drejtë ta revokojë vendimin, në varësi të negociatave përfundimtare të projektit. Po ashtu, shtetit shqiptar, u tha në dokument, i është dhënë edhe opsioni i daljes nga ky investim.

Projekti i investimit do të ndahet në tri faza, por në vendimin e publikuar nuk jepen hollësi se çfarë përfshin secila prej tyre.

### Plani i Kushnerit për Sazanin

Në mars të vitit 2024 Kushneri kishte publikuar në rrjetet sociale dizajnet potenciale të investimeve të firmës së tij në Shqipëri. Kushner kishte deklaruar se synon ta



shndërrojë ishullin më të madh të Shqipërisë, Sazan, që gjendet në Detin Mesme, në një destinacion luksoz për turistët.

Sazani është kryesisht i braktisur dhe aktualisht është bazë ushtarake dhe gjysmë i hapur për publikun.

Dhëndëri i presidentit të zgjedhur amerikan, Donald Trump, ka deklaruar se dëshiron të ndërtojë disa hotele dhe qindra vila në Zvërnec, një zonë bregdetare në Vlorë, në jug të Shqipërisë. Në të kaluarën, sa i përket

Zvërnecit, qeveria shqiptare kishte thënë se zyrtarisht nuk ka pranuar ndonjë shprehje interesi lidhur me këtë investim.

Planet e Kushnerit ishin përballur me kundërshtime në Shqipëri, sidomos nga ambientalistët që kishin thënë se mund të shkaktohen dëme në zonat e mbrojtura bregdetare.

Në mars të vitit të kaluar ekipi i Radios Evropa e Lirë vizitoi ishullin e Sazanit.

Ky ishull për dekada të tëra ishte i mistershëm. Në të dihej

se ishte një bazë e rëndësishme ushtarake, para dhe gjatë kohës së Shqipërisë komuniste.

Tani, herë pas here, ky ishull në Vlorë përdoret nga ushtria e Shqipërisë dhe NATO-ja.

Ishulli i Sazanit ka sipërfaqe rreth 6 kilometra katrorë dhe vijë bregdetare me gjatësi rreth 15 kilometrash katrorë. Aty ende nuk ka energji elektrike, as ujë të pijshëm. Megjithatë, aty ka shumë bunkerë, numri i saktë i të cilëve nuk dihet. Përveç në Shqipëri, Kushneri synon të investojë edhe në Serbi.

## Feride Rushiti dhe QKRMT-ja nominohen për Çmimin Nobel për Paqe

PRISHTINË, 17 JANAR - Feride Rushiti dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) janë nominuar për Çmimin Nobel për Paqe për vitin 2025.

Nominimin e ka bërë deputeti i Parlamentit suedez, Magnus Jacobsson, i cili në letrën dërguar Komitetit të Institutit norvegjez të Nobelit, ka thënë se këtë vendim e ka ndërmarrë për t'i njohur "kontributet e jashtëzakonshme" të Rushitit dhe QKRMT-së "në avancimin

e të drejtave të njeriut, dinjitetit të të mbijetuarve dhe shërimit të plagëve të luftës të komuniteteve". "Çmimi Nobel për Paqe synon t'i vlerësojë individët, puna e të cilëve nxit paqen, drejtësinë dhe pajtimin. Feride Rushiti dhe QKRMT-ja i mishërojnë këto ideale përmes përkushtimit të tyre të përjetshëm për t'i mbështetur njerëzit më të cenueshëm, duke shëruar plagët e konfliktit dhe duke ndërtuar një bazë për paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe përtej", shkroi ai.

Pas publikimit të letrës nga deputeti suedez, Rushiti tha se është e nderuar dhe shprehu mirënjohje për këtë nominim. Feride Rushiti ka themeluar QKRMT-në më 1999 me misionin për të ofruar trajtim dhe rehabilitim për viktimat e torturës në Kosovë. Kjo qendër, po ashtu, promovon respektimin e të drejtave të njeriut për të gjitha etnitë që jetojnë në Kosovë dhe të parandalimit dhe çrrënjësjes e torturës dhe të gjitha formave të keqtrajtimin.





## PDK-ja bën thirrje të shmangët gjuha nxitëse dhe fyese në fushatën zgjedhore

PRISHTINË, 17 JANAR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka bërë thirrje që në këtë fushatë të përdoret gjuhë e respektueshme, të shmangët çdo gjuhë nxitëse, fyese ose urrejtjeje, si në komunikimet publike ashtu edhe në ato private. "Le të reflektojnë diskursi ynë dinjitetin e kauzës sonë. Promovoni drejtësinë dhe transparencën: Jepni kontributin tuaj për një proces zgjedhor të drejtë, transparent dhe pa konflikte, duke siguruar që veprimet tona të përputhen

me parimet demokratike. Ruani sjelljen shembullore: Përfaqësoni vlerat e PDK-së me dinjitet, përgjegjësi dhe një sjellje shembullore që frymëzon besim dhe unitet. Respektimi i ligjeve dhe rregullave zgjedhore nuk është vetëm një detyrim ligjor - është një përgjegjësi morale që forcon demokracinë tonë dhe ndërton themelet për suksesin tonë të përbashkët. Së bashku, përmes përkushtimit dhe mbështetjes suaj të palëkundur, mund të arrijmë

një fitore që nderon idealet e drejtësisë, integritetit dhe respektit për të gjithë", është thënë në njoftimin e PDK-së. PDK-ja ka theksuar se ka qenë gjithmonë një shtyllë e demokracisë, një forcë që mbron sundimin e ligjit dhe respekton rregullat e vendosura, veçanërisht gjatë proceseve zgjedhore. "Ndërsa vazhdojmë misionin tonë, roli juaj si përfaqësues të vlerave tona të përbashkëta është më i rëndësishëm se kurrë", ka njoftuar PDK-ja.



## Kosova investon në konkurrueshmëri dhe konektivitet me mbështetjen e Bankës Botërore

PRISHTINË, 17 JANAR - Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë i Bankës Botërore aprovoi sot asistencën financiare për dy projekte të reja në Kosovë me qëllim të forcimit të konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe përmirësimit të konektivitetit.

Në njoftimin e bërë për medie thuhet se si Projekti për Zhvillimin e Sektorit Financiar, me vlerë prej 52 milionë dollarësh (49.1 milionë eurosh), ashtu edhe Projekti për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit (TTFP) 2.0, me vlerë prej 37.7 milionë dollarësh (34.7 milionë eurosh), po financohen përmes kredive koncesionare nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA). "Nëpërmjet këtyre dy projekteve Kosova demonstroi zotimin për ta fuqizuar konkurrueshmërinë duke mbështetur firmat e vogla që janë thelbësore për ekonominë", thotë



Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. "Përqendrimi në përmirësimin e qasjes në financa për bizneset dhe lehtësimin e konektivitetit është një faktor kyç për rritje dhe për krijimin e vendeve të punës, dhe kjo do të sjellë përfitime të qarta për Kosovën dhe qytetarët e saj". Më tutje, në njoftim thuhet se Projekti për Zhvillimin e Sektorit Financiar synon që ta

përmirësojë stabilitetin dhe përfshirjen financiare në Kosovë përmes forcimit të kapacitetit të Fondit të Sigurimit të Depozitave, financimit të ndërmarrjeve më pak të përkrahura dhe nxitjes së pagesave më të shpejta. "Ky projekt do ta forcojë kapacitetin e Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës për t'i mbrojtur kursimet e qytetarëve dhe bizneseve në Kosovë dhe do ta mbështetë Bankën Qendrore

të Kosovës në promovimin e sistemeve moderne dhe digjitale të pagesave. Projekti, gjithashtu, do ta përmirësojë mjedisin financiar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme duke alokuar kapital për garantimin e kredive përmes Fondit Kosovor për Garanci Kreditorë, duke tërhequr potencialisht rreth 200 milionë dollarë investime nga sektori privat", bëhet me dije në komunikatë.

Ky projekt do ta ndihmojë edhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për krijimin e një Banke Kombëtare për Zhvillim, e cila do të financojë projekte zhvillimore që janë në përputhje me prioritetet e qeverisë.

Projekti për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit 2.0, i cili ndërtohet mbi suksesin e TTFP 1 në uljen e kostove tregtare dhe rritjen e efikasitetit të

transportit në Ballkanin Perëndimor, do ta financojë infrastrukturën kritike dhe sistemet e teknologjisë informative për ta përshpejtuar lëvizjen e mallrave dhe lehtësuar tregtinë në mes të Kosovës dhe vendeve fqinje.

Ky projekt do të investojë në softuerë, pajisje harduerike, pajisje komunikimi dhe infrastrukturë të ndërlidhur për t'i implementuar sistemet e pagesës elektronike rrugore në segmentet kryesore rrugore në Kosovë, duke përfshirë Korridorin 6, Korridorin 7 dhe Autostradën e Gjilanit. Për më tepër, për ta përmirësuar sigurinë rrugore dhe hekurudhore, projekti do ta financojë përmirësimin e 21 vendkalimeve të hekurudhës përgjatë rrjetit kryesor dhe seksionit me trezik të lartë rrugor ndërmjet Fushë-Kosovës dhe Gjurgjicës, që shtrihet një gjatësi prej 28 kilometrave.

## Nënshkruhet marrëveshja 86 milionë euro për renovimin e ndërtesave publike

PRISHTINË, 17 JANAR - Të premtën është mbajtur ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes për eficiencë të energjisë e cila parashihet investime në 400 ndërtesa publike në Kosovë. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ministri i Ekonomisë, Artane Rizvanolli, drejtori i BERZh-it në Kosovë, Sergiy Maslichenko, si dhe drejtori menaxhues i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Driton Hetemi. Në fjalën e tij ministri Murati



theksoi se marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), me një financim prej 50 milionë eurosh tashmë është negociuar dhe nënshkruar. "E

mira e kësaj marrëveshje është që e njëjta përfordhet edhe më tej me grantin e mbështetjen prej 20 milionë eurosh të siguruar nga institucionet e tjera partnere, siç janë Bashkimi

Evropian dhe Qeveria e Danimarkës", ka deklaruar ministri Murati.

Ministrja Rizvanolli theksoi se është e domosdoshme që ndërtesat publike të jenë të izoluara mirë dhe të kenë masa të eficiencës në mënyrë që konsumi i përgjithshëm në vend të ulet, rrjedhimisht të lehtësohet sistemi elektroenergetik dhe të reduktohen kostot financiare. Nga ana e tij, drejtori i BERZh-it në Kosovë, Maslichenko, theksoi se ky projekt dëshmon partneritetin e fortë ndërmjet

BERZh-it dhe Kosovës. Ndërsa drejtori menaxhues i FKEE-së, Driton Hetemi, nënvizoi se projekti pritet të nisë gjatë këtij viti dhe do të përfundojë deri në vitin 2031.

Kjo marrëveshje është vetëm një fragment i punës disavjeçare të qeverisë në sigurimin e eficiencës së energjisë pasi iniciativa të ngjashme janë nënshkruar me komunën e Prishtinës dhe komunën e Prizrenit për ndërtesat publike në këto komuna, ku totali i vlerës së atyre projekteve ka qenë 30 milionë euro.

## Bëhen homazhe në përvjetorin e vrasjes së heronjve Kadri Zeka dhe Jusuf e Bardhosh Gërvalla

GJILAN, 17 JANAR - Në 43-vjetorin e vrasjes së veprimtarëve të shquar të çështjes kombëtare, Kadri Zeka e Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla, janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve, varri dhe

shtatorja e heroit Kadri Zeka në Gjilan. Për ta nderuar jetën dhe veprën e tre heronjve ishin edhe kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, përfaqësues nga Organizata e

Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zyrtarë komunalë, të subjekteve politike, familjarë të heroit Kadri Zeka, miq dhe qytetarë.

Kadri Zeka dhe vëllezërit

Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla si veprimtarë të shquar të çështjes kombëtare u vranë më 17 janar të vitit 1982 nga shërbimi sekret jugosllav 43 vjet më parë në Shtutgart të Gjermanisë.





# ATK-ja 25 vjet punë, mbi 11 miliardë euro rezultat



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 17 JANAR** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka shënuar 25-vjetorin e themelimit të saj, me një ceremoni solemne, në të cilën morën pjesë udhëheqës të lartë të shtetit, ambasadorë të vendeve të fuqishme që veprojnë në Kosovë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe shumë të ftuar të tjerë. Në këtë ngjarje të veçantë të pranishmit vlerësuan rrugëtimin e ATK-së gjatë çerek shekullit të fundit, duke theksuar rolin e saj kyç në ndërtimin dhe zhvillimin e institucioneve të Kosovës. Fjalimet kryesore u fokusuan në sfidat e tejkaluara, mbështetjen ndërkombëtare të dhënë ndër vite, reformat institucionale, proceset e digjitalizimit dhe arritjet rekorde në rritjen e të hyrave.

Drejtori i përgjithshëm, Ilir Murtezaj, në fjalimin e tij tha se "misioni i ATK-së është ngritja e nivelit më të lartë të përmbushjes vullnetare në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, si dhe ofrimi i shërbimeve profesionale, transparente dhe efektive për tatimpagues. ATK-ja ka obligim të vendosur me ligj që të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të

dispozitave ligjore për të gjithë tatimpaguesit, në mënyrë të njëjtë për situata të njëjta. Ne drejtuesit dhe gjithë punonjësit e Administratës Tatimore të Kosovës këtë mision e konsiderojmë si mision të shenjtë dhe punojmë shumë që askush dhe asnjëherë të mos guxojë të shkelë mbi këtë mundësi që na është ofruar për t'i shërbyer vendit tonë". Më tutje, ai ka theksuar se si rezultat i punës profesionale, me integritet dhe ndershmëri, efektivitet dhe transparencë, Administrata Tatimore e Kosovës për këto 25 vjet ka mbledhur mbi 8 miliardë euro tatime, dhe mbi 3 miliardë euro kontribute pensionale. "Pra, gjithsejtë mbledhje të të hyrave mbi 11 miliardë euro. Po ashtu, i pari i ATK-së tha se, krahas rritjes së të hyrave, ne vazhduam reformim institucional, reforma këto të cilat transformuan institucionin e ATK-së, nga një administratë tatimore modeste, në një administratë tatimore moderne", ka thënë Murtezaj. Ambasadorët e vendeve të fuqishme në Kosovë në fjalimet e tyre e vlerësuan lart angazhimin dhe përkushtimin e ATK-së për të ndërtuar një sistem tatimor të drejtë dhe të qëndrueshëm, duke theksuar mbështetjen e vazhdueshme të dhënë përmes projekteve dhe

ekspertizës ndërkombëtare. Përfaqësuesja nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Eileen Devitt, tha se është nder i madh për mua që të jem sot këtu për të shënuar këtë çast të rëndësishëm, 25-vjetorin e themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës. Sipas saj, ky përvjetor nuk është thjesht një shënim i kalimit të kohës, por një dëshmi e përkushtimit, profesionalizmit dhe suksesit të arritur nga ky institucion në ndërtimin e themeleve të qëndrueshme për të ardhmen e Kosovës. "Sistemi tatimor është themeli mbi të cilin ngrihet një shtet i fortë dhe i qëndrueshëm. Një administratë tatimore e besueshme dhe efikase jo vetëm që siguron burime për zhvillimin ekonomik dhe shërbimet publike, por rrit besimin e qytetarëve në institucione dhe në drejtësinë e sistemit. ShBA-ja ka qenë dhe mbetet krenare për mbështetjen që ka ofruar në zhvillimin e Administratës Tatimore të Kosovës. Kjo mbështetje ka përfshirë trajnime, ndihmë teknike dhe partneritet për t'i avancuar proceset e digjitalizimit, transparencës dhe llogaridhënies. Jemi të lumtur që kemi qenë pjesë e rrugëtimin tuaj, dhe rezultatet flasin vetë: të ardhurat rekord, reformat e guximshme dhe ndërtimi i një

administratë moderne që u shërben qytetarëve të saj me efikasitet dhe integritet", ka thënë ajo. Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, gjatë fjalimit të tij në ceremoninë e 25-vjetorit të Administratës Tatimore të Kosovës, vlerësoi bashkëpunimin afatgjatë në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar për ndërtimin e kapaciteteve institucionale të ATK-së. Ai theksoi kontributin e ekspertëve britanikë në avancimin e proceseve kyçe, si menaxhimi i riskut, lufta kundër evazionit fiskal dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve. Ambasadori nënvizoi rëndësinë e vazhimit të shkëmbimit të përvojave ndërkombëtare për të siguruar një sistem tatimor modern, transparent dhe të drejtë, duke shprehur gatishmërinë e Mbretërisë së Bashkuar për t'i mbështetur me tej reformat dhe zhvillimin e mëtejshëm të ATK-së. Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, në fjalimin e tij gjatë ceremonisë së 25-vjetorit të Administratës Tatimore të Kosovës, theksoi mbështetjen e vazhdueshme që shteti gjerman ka ofruar përmes organizatës GIZ. Ai vlerësoi rezultatet e dukshme të këtij

bashkëpunimi, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve institucionale të ATK-së, përmirësimin e procedurave tatimore dhe zhvillimin e sistemeve të digjitalizuara. Ambasadori gjerman nënvizoi se përkushtimi i Gjermanisë për ta mbështetur Kosovën në ndërtimin e një administratë moderne dhe të përgjegjshme do të vazhdojë, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të vendit.

Përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Sebastian Sosa, në fjalën e tij gjatë ceremonisë së 25-vjetorit të Administratës Tatimore të Kosovës, vlerësoi përparimin e jashtëzakonshëm të ATK-së për ndërtimin e një administratë tatimore efikase dhe transparente. Ai theksoi se ATK ka luajtur rol të rëndësishëm në sigurimin e të hyrave të qëndrueshme për buxhetin e Kosovës, duke ndihmuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin financiar të vendit. Përfaqësuesi i FMN-së u shpreh se institucioni që ai përfaqëson mbetet partner i përkushtuar për mbështetjen e reformave dhe përmirësimin e mëtejshëm të proceseve tatimore në Kosovë. Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, tha se "sot është një ditë e veçantë, pasi shënojmë 25-vjetorin e themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës, një institucion që ka luajtur një rol jetik në zhvillimin ekonomik të vendit tonë".

Ai ka thënë se në këto dy dekada e gjysmë ATK-ja jo vetëm që ka përmbushur misionin e saj për të mbledhur të hyrat publike, por ka ndikuar thellësisht edhe në ndërtimin e një kulture të re të vetëdijes tatimore. "Nëpërmjet punës së saj të palodhshme, ATK ka ndërgjegjësuar qytetarët dhe bizneset se pagimi i tatimeve nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një akt përgjegjësie shoqërore, që kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të mirë dhe më të drejtë", ka theksuar Rafuna.

Ngjarja u përmbyll me një falënderim të veçantë për të gjithë ata që kanë kontribuar në suksesin e ATK-së ndër vite dhe një zotim për t'i vazhduar përpjekjet drejt modernizimit dhe përmirësimin të mëtejshëm të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

## Investitorët amerikanë të kriptovalutave për herë të parë do të tatimohen

**WASHINGTON, 17 JANAR** - Në muajt e ardhshëm shumica e amerikanëve do të përqendrohen në mbledhjen e dokumenteve të tyre tatimore për t'i përfunduar deklaratat e tyre të tatimeve për vitin 2024. Por për këdo që blen dhe shet asete digjitale si Bitcoin është e rëndësishme të

dihet se viti 2025 do të jetë viti i parë fiskal kur transaksionet tuaja me kriptovaluta do të jenë subjekt i kërkesave për raportim nga palët e treta - që do të thotë se informacioni për to do t'i dërgohet IRS-it (Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme) - nëse transaksionet tuaja kryhen në

një llogari kujdestare në një platformë të centralizuar tregtare të kriptovalutave, siç janë Coinbase ose Gemini. Kompanitë që do të kenë përgjegjësi për këtë raportim janë "brokerat që marrin në zotërim asetet digjitale që shiten nga klientët e tyre. Këta ndërmjetës përfshijnë

operatorët e platformave tregtare të aseteve digjitale kujdestare, disa ofrues të portofoleve të strehuar të aseteve digjitale, kioskat e aseteve digjitale dhe disa përpunues të pagesave të aseteve digjitale (PDAPs)", vuri në dukje IRS-i në faqen e saj.





# Kalorësit Templarë: Bankierët e parë të Evropës, që transformuan Financat



Kur mendoni për Kalorësit Templarë, imazhi që ju vjen në mendje mund të jetë ai i një rendi të fuqishëm ushtarak që mbrojtë të krishterët dhe shenjtërit në Tokën e Shenjtë. Por, a e dini se përveç shpatave dhe mburojave, ata kishin edhe një armë tjetër shumë të fuqishme – sistemin financiar? Në fakt, Kalorësit Templarë ishin jo vetëm një rend fetar dhe ushtarak, por edhe pionierët e bankave në Evropën Mesjetare.

## Si e ndërtuan një perandori financiare?

### 1. Sistemi i Parë i "Kartave të Kreditit"

Kalorësit Templarë krijuan një sistem të sofistikuar të transferimit të parave që eliminonte nevojën për të udhëtuar me shuma të mëdha parash. Pelegrinët mund të depozitonin pasuritë e tyre në një degë të Templarëve dhe

merrnin një "leter krediti" që mund ta shkëmbenin për para në destinacionin e tyre. Ky ishte një hap i jashtëzakonshëm drejt zhvillimit të sistemit modern bankar dhe reduktonte rreziqet nga hajdutët.

### 2. Ruajtja e pasurive dhe dhënia e huave

Në një epokë kur sigurimi i pasurive ishte një sfidë, Templarët ofronin ruajtje të sigurt për objekte me vlerë dhe pasuri të tjera. Përveç kësaj, ata jepnin hua për mbretër dhe fisnikë, duke ndihmuar në financimin e luftërave, ndërtimin e katedraleve dhe zhvillimin e projekteve madhore.

### 3. Operacione financiare në shkallë të gjerë

Falë rrjetit të tyre të pasurive dhe degëve në gjithë Evropën dhe

Lindjen e Mesme, Templarët kishin aftësinë të transferonin dhe menaxhonin pasuri masive. Në disa raste, ata kontrollonin financat mbretërive të tëra, duke fituar ndikim të jashtëzakonshëm politik dhe ekonomik.

### 4. Themelet e bankave moderne

Përmes zhvillimit të letrave të kredisë dhe sistemit të tyre financiar, Kalorësit Templarë kontribuan në konceptin e bankave, ashtu si ne e njohim sot. Ata ishin të parët që krijuan sisteme të organizuara të depozitave, huave dhe transferimit të fondeve, duke hapur rrugën për bankat që do të pasonin në shekujt e ardhshëm.

### Rënia dhe trashëgimia

Edhe pse fuqia e tyre mori fund në

mënyrë dramatike në fillim të shekullit të 14-të, kur u shpallën heretikë dhe u shpërndanë nga Papa dhe mbretërit, trashëgimia financiare mbetet e gjallë. Shumë nga idetë e tyre vazhduan të përdoren dhe u përmirësuan nga bankierët e Rilindjes në Itali, duke ndikuar në zhvillimin ekonomik të Evropës.

Kalorësit Templarë ishin pra, më shumë se luftëtarë; ata ishin vizionarë financiarë që sollën inovacione që i paraprinë bankave moderne. E tyrja, është historia e një rendi fetar-ushtarak, i cili mundi të ketë një ndikim të madh ekonomik që vazhdon të ndihet edhe sot e kësaj dite. Shpesh pasuria e vërtetë nuk qëndron vetëm tek shpata, por mbi të gjitha tek mendjet që dinë ta menaxhojnë. / bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Superliga vazhdon përballjet interesante



**GJAKOVË, 17 JANAR** - Fundjava sjell sfida interesante në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll, që sa vjen e bëhet më interesante. Takimi i parë do të zhvillohet ndërmjet Borës dhe Pejës. Skuadra prishtinase është në vendin e shtatë me pesë fitore dhe 11 humbje, ndërsa pejanët në pozitën e tretë me nëntë fitore e shtatë humbje. Vëllaznimi - Trepça takohen në një tjetër takim interesant të shtunën. Kuqezinjtë janë në formë shumë të mirë, ku kanë katër fitore në pesë ndeshjet e fundit

në elitë, derisa kampionët janë në vendin e parë me 12 fitore e katër humbje, ndërsa skuadra nga Gjakova ka tetë fitore e tetë humbje. Ndeshja do të zhvillohet në Mitrovicë. Përballje interesante shihet edhe ajo ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës. Ylli ka shtatë fitore dhe nëntë humbje, kurse prishtinasit tetë fitore dhe tetë humbje, andaj pritet një takim i baraspeshuar në Therandë. Java e 17 do të mbyllet me derbin prizrenas në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Bashkimit. Proton Cable

Prizreni është në vendin e tetë me katër fitore dhe 12 humbje, kurse Bashkimi në pozitën e dytë me 11 fitore dhe pesë humbje.

## PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 17

### Të shtunën takohen:

17:00 Bora - Peja  
19:00 Vëllaznimi - Trepça

### Të dielën takohen:

17:00 G. Eagle Ylli - Sigal Prishtina  
19:00 Proton Cable Prizreni - Bashkimi

## SHKURT

### Federatës së Karatesë i është besuar organizimi i Kampionatit Mesdhetar

Federatës së Karatesë së Kosovës (FKK) i është besuar organizimi i Kampionatit Mesdhetar, që prej 12-14 shtator 2025 do të organizohet në Prishtinë. "Ky vendim historik erdhi pas vizitës së presidentit të WKF-it, Antonio Espinos dhe sekretarit të EKF-it, Davor Cipek, në Kosovë, gjatë shënimit të 10-vjetorit të njohjes së KOK-ut nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar", thuhet në njoftimin e FKK-së. Pjesëmarrëse do të jenë 26 shtete nga tri kontinente. KOK-u përgëzon FKK-në për marrjen e këtij organizimi, i cili do të shërbejë edhe si test për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030" në sportin e karatesë.

### Kampionati i Kosovës në xhudo mbahet të dielën

Federata e Xhudos së Kosovës ka njoftuar se të dielën do të mbahet kampionati i xhudos në Pejë. Pjesëmarrëse do të jenë të gjitha klubet e Kosovës. "Më 19 janar 2025 në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë, duke filluar nga ora 10:00, do të mbahet Kampionati i Kosovës për Seniorë. Në këtë kampionat do të marrin pjesë të gjitha klubet e Kosovës me garuesit e tyre më të mirë në kategorinë e seniorëve. Ejani dhe shijoni një ditë të mbushur me gara dhe përballje të nivelit të lartë në mes të xhudistëve më të mirë të vendit", thuhet në njoftimin e FXhK-së.

### Monza synon transferimin e Mërgim Berishës

Një tjetër sulmues shqiptar mund të bëhet pjesë e Serisë A gjatë merkatos së janarit. Mediet gjermane dhe ato italiane bëjnë me dije se klubi i Monzës ka piketuar si përforsim për repartin e avancuar Mërgim Berishën. Futbollisti 26-vjeçar i cili përfaqëson Gjermaninë në arenën ndërkombëtare, është në pronësi të Hofenhaimit, por nuk po aktivizohet rregullisht me këtë skuadër si pasojë e telasheve me dëmtimet që ka kaluar në vitet e fundit. Monza është gati t'i ofrojë atij mundësinë ta tregojë talentin në elitën e futbollit italian dhe, sipas "Sky Deutschland", kontaktet mes palëve kanë nisur në këto ditë. Megjithatë, Berisha ka oferta edhe nga klube të tjera në Gjermani dhe po shqyrton mundësitë që i vihen përpara. Formula e transferimit është ajo e huazimit me të drejtë blerje për lojtarin, i cili ka luajtur dy ndeshje miqësore me përfaqësuesen A të Gjermanisë.

## Llapi paraqet portierin Marijan Coric

Podujevë, 17 janar - Skuadra e Llapit e ka paraqitur portierin shtatllartë, Marijan Coric, i cili ka përfunduar me sukses të gjitha çështjet procedurale dhe tashmë është bashkuar me ekipin në stërvitje. Ky transferim i rëndësishëm sjell një përforsim të madh në portën e skuadrës së Llapit, ndërsa Coric do të jetë një shtyllë e fortë në mbrojtjen e ngjyrave bardh e kaltër.

Drejtori sportiv, Mentor Zhdrella, i ka uruar mirëseardhje lojtarit të ri duke shprehur besimin e plotë në cilësitë e tij. "Coric është një portier me përvojë dhe cilësi të larta. Jemi të lumtur që e kemi sërish në mesin tonë dhe jemi të bindur që ai do të japë kontribut të madh në arritjen e objektivave tona", ka thënë Zhdrella. Në anën tjetër, Coric është shprehur: "Jam shumë i

lumtur që rikthehem sërish këtu. Kam kujtime të shkëlqyera nga periudha ime e mëparshme dhe mezi pres ta shpërblej besimin e drejtuesve të klubit. Do ta jap maksimumin për ta ndihmuar ekipin në arritjen e objektivave tona dhe për t'i gëzuar tifozët 'Legjendat' me fitore të reja, sepse ata me të vërtetë e meritojnë! Mirë se u ktheve në shtëpi, Marijan!"





## Haalandi nënshkruan kontratë të re me City

MANCHESTER, 17 JANAR - Erling Haaland ka nënshkruar kontratë nëntëvjeçare e gjysmë me Manchester City, duke zgatur qëndrimin deri në verën e vitit 2034. City ka arritur marrëveshje rinovimi me sulmuesin 24-vjeçar duke nënshkruar kushte të reja në kontratë, ndër më

fitimprurëset në histori të sportit. Ky njoftim u konfirmuar edhe nga vetë klubi anglez me anë të një postimi. "Erling Haaland ka nënshkruar një kontratë të re 10-vjeçare me Manchester Cityn, duke e mbajtur atë në klub deri në verën e vitit 2034", thuhet në njoftim.

Ndonëse nuk është konfirmuar, mediet angleze zbulojnë se ai do të fitojë 590 mijë euro në javë, shifër kjo që nuk është parë kurrë në Ligën Premierë. Nga detajet që dihen zyrtarisht, theksohet se Haalandi do të ketë një klauzolë në kontratë, por aktive vetëm nga viti 2029,

për të gjitha klubet që duan ta blejnë. Shifra do të jetë jashtëzakonisht e lartë. Haalandi iu bashkua Cityt nga Borussia Dortmundi në vitin 2022 dhe nën urdhrat e Pep Guardiolas u bë një nga sulmuesit më vdekjeprurës në botë. Norvegjezi ka shënuar 111 gola në 126 ndeshje me



Cityn, teksa ka fituar dy Liga Premierë, një Ligë të Kampionëve, Kupën FA dhe Superkupën e Evropës.

## Ndikimi i shqiptarëve në futbollin zviceran

CYRIH, 17 JANAR - Para pak ditësh janë shpallur më të mirët e futbollit në Zvicër për vitin 2024. Nga katër çmime për futbollistë, mbrëmja gala u dominua nga shqiptarët. Granit Xhaka është shpallur futbollisti më i mirë i përfaqësueses së Zvicrës për vitin 2024. Lojtari më i mirë i ri për vitin 2024 u shpall Ardon Jashari, ndërsa lojtari më i mirë i Challenge League, që është kategoria e dytë zvicerane, u shpall Valon Fazliu. Renato Steffen ishte i vetmi lojtar joshqiptar, i shpërblyer. Ai u shpall lojtari më i mirë i Superligës së Zvicrës për vitin 2024. Ceremonia në Bernë vetëm konfirmoi atë që dihet për shumë kohë, se ndikimi i shqiptarëve në futbollin e Zvicrës është shumë i madh. Xhaka u shpall për herë të tretë radhazi lojtari më i mirë i përfaqësueses. Pak ditë më parë ai mori çmimin MVP në ceremoninë e shpalljes së sportistëve më të mirë të Zvicrës për vitin e kaluar. Jashari është e ardhmja e përfaqësueses helveteke, ndërsa Fazliu ka kohë që shkëlqen në kategorinë e dytë zvicerane. Emra të tjerë të rëndësishëm të futbollit shqiptar si Valon Behrami, Blerim Xhemaili, Admir Mehmedi e



Albert Bunjaku kanë përfunduar karrierën tashmë. Xherdan Shaqiri i ka dhënë fund karrierës me përfaqësuesen, por shqiptarët mbesin me ndikim të madh në shtetin helvetik. Granit Xhaka aktualisht është i pakrahasueshëm për nivelin që ka arritur. Përveçse udhëheq Zvicrën si kapiten, ai ka pasur suksese kulmore edhe me Bayer Leverkusenin, duke fituar titullin e kampionit në Bundesligë. Aktualisht po paraqitet me sukses edhe në Champions. Klubet e Zvicrës vazhdojnë të jenë të mbushur me lojtarë shqiptarë, njësoj si përfaqësueset e grupmoshave dhe akademitë e klubeve. Është e sigurt se futbollistë shqiptarë do ta fitojnë titullin në Superligën e Zvicrës. Kryesueset aktualisht është

Lugano, skuadër në të cilën paraqiten Alban Hajdari, Uran Bislimi, Shkëlqim Vladi e Amir Shaipi. Te Baseli i vendit të dytë janë Xherdan Shaqiri, Taulant Xhaka, Leon Avdullahu e Alban Ajeti. Te Lausanne e vendit të tretë është Alban Ajdini. Luzerni është në vendin e katërt, kurse për këtë skuadër luan Donat Rrudhani. Me trendin aktual, shqiptarët do të fitojnë çmime të rëndësishme edhe në të ardhmen. Shpesh shqiptarët e rritur në Zvicër kritikohen kur nuk zgjedhin të luajnë për Kosovën apo Shqipërinë. Por lidhja e tyre me vendin e origjinës vazhdon të jetë shumë e fortë, në të shumtën e rasteve. Dhe prej nivelit që kanë shqiptarët në Zvicër, vazhdimisht përfitojnë edhe Kosova dhe Shqipëria.

### SHKURT

#### Chelsea i kërkon Evertonit kompensim për ta rikthyer Brojën

Klubi londinez Chelsea thuhet se ka kërkuar nga Evertoni kompensim nëse do ta ndërpresë huazimin e sulmuesit shqiptar Armando Broja. Sipas "The Guardian", Chelsea i ka kërkuar Evertonit kompensim për ta rikthyer sulmuesin shqiptar nga huazimi i tij. Së fundmi Broja ka pësuar një dëmtim që do ta mungojë për rreth tre muaj. Si rezultat, Evertoni dëshiron ta shkurtojë huazimin dhe ta kthejë lojtarin te Chelsea. Toffees ka përdorur tashmë të katër vendet e disponueshme të huazimit dhe po kërkon të lirojë hapësirë për të nënshkruar me një tjetër sulmues në huazim. Megjithatë, Chelsea po kërkon dëmshpërblim përpara se ta lejojë kthimin e Brojës në "Stamford Bridge". Broja ka luajtur gjashtë ndeshje për Evertonin këtë sezon pa shënuar asnjë gol apo asistim.

#### Te Ferrari bëhen gati për debutimin, Hamiltoni në Maranello për ta parë makinën e re

Numërimi mbrapsht pothuajse ka përfunduar. Brenda pak ditësh Lewis Hamiltoni do të jetë për herë të parë në Maranello, më saktësisht javën e ardhshme. CEO i Ferrarit, Benedetto Vigna, e konfirmoi këtë gjatë një eventi në Milano. "Te Ferrari ka një emocion të madh, një dëshirë të madhe për të filluar. Ne jemi duke përgatitur gjërat e fundit. Lewisi do të jetë në Maranello javën e ardhshme. Ne jemi gati për gjithçka. Ndryshimet janë gjithmonë të mira", ka thënë Vigna. Piloti britanik, shtatë herë kampion bote në Formula 1, pritet që jo vetëm t'i shohë mjediset e reja të punës, por edhe të provojë një makinë të vjetër Ferrari. Ai do të shohë nga afër se si funksionon "kokëkuqja". Hamiltoni do ta shohë përparimin e bërë me makinën e re Ferrari, që do ta pilotojë këtë vit. Në shkurt do të zhvillohen testet e vetme dimërore dhe ai do të jetë momenti i parë që do ta provojë njëvendëshen e re.

#### Neymari: Lëndimet ma mohuan 'Topin e Artë'

Braziliani Neymar ka pranuar se lëndimet e shumta ia kanë dëmtuar rëndë karrierën dhe kjo ka bërë që ai të mos ketë mundësinë edhe për ta fituar "Topin e Artë". "Sot mendoj se kam qenë i pafat me dëmtimet. Është si 7 vjet radhazi që lëndohem. Janë lëndime që më nxjerrin jashtë për 3 muaj, 6 muaj. Kjo është ajo që më pengoi. Nëse ndaloni dhe mendoni për këtë, kushdo që di për futbollin, e di kulmin tim. Kulmi im ishte te PSG-ja. Duke luajtur ashtu siç isha në PSG, do të fitoja absolutisht një "Top të Artë", ka thënë Neymar. "Jam i sigurt për këtë. Por unë i kam pasur ato lëndime, më kanë dëmtuar. Natyrisht, çdo lojtar dëshiron të fitojë një dhe ta ketë një në shtëpi, por kjo nuk është diçka që më shqetëson mua. Jeta vazhdon, Zoti nuk e donte, kjo është mirë", ka shtuar Neymar.

## Oklahoma fiton duelin e kreut ndaj Clevelandit

OKLAHOMA, 17 JANAR - Skuadra e Oklahomas fitoi me rezultat 134-114 ndaj Clevelandit në përballjen mes dy ekipeve më të mira këtë sezon në NBA. Një ndeshje e dominuar nga vendësit, ku Alexander Shai ishte i papërmbajtshëm në fushë, autor i 40 pikëve. Tashmë



të dy ekipet kanë të njëjtin numër fitoresh e humbesh (34/6). Fitore të rëndësishme jashtë fushës korri ekipi i Phoenixit, që mundi me shifrat 130-123 Washingtonin, ndeshje

ku shkëlqeu Devin Booker, autor i 37 pikëve. Ai u mbështet edhe nga Duranti me 23 pikë. Indiana, falë 54 pikëve të dyshes Siakam - Turner, mundi me rezultat 111-100 Detroitin në fushën e këtij të fundit. Një paraqitje të mirë bëri skuadra e Clippersave, që mundi me rezultat 118-98 Portlandin. Vendimtar ishte stoli i ekipit kalifornian, nga erdhën 46 pikë. Një ndeshje të mirë bëri ekipi i Sacramentos, që në shtëpi mundi me rezultat 132-127 Houstonin, ku DeRozani me 33 pikë ishte lider për Kingsin, më i miri në fushë.

### REZULTATET

Detroit - Indiana	100-111
Washington - Phoenix	123-130
Oklahoma - Cleveland	134-114
Portland - Clippers	89-118
Sacramento - Houston	132-127

## Pretendentët kalojnë në raundin e katërt

Ka nisur sot në Melburn raundi i tretë i grand slamit të "Australian Open" në tenis. Tenisti serb Novak Djoković, 10 herë fitues i këtij turneu, fitoi 3-0 (6-1, 6-4, 6-4) ndaj Tomas

Mahac dhe avancon më tej. Në raundin e katërt shkon edhe spanjollli Carlos Alcaraz, që mundi 3-1 (6-2, 6-4, 6-7, 6-2) Nuno Borges. Nuk zhgënjën as numri 2 në botë, gjermani

Alexander Zverev, që mundi 3-0 (6-3, 6-4, 6-4) Jacob Fearnley. Te femrat, një biletë për më tej siguroi tenistja bjelloruse Aryna Sebalenka, numri 1 në botë. Ajo fitoi 2-0 (7-6, 6-4) ndaj Clara

Tauson. Nga gara është eliminuar Naomi Osaka, që u tërhoq pasi humbi setin e parë (6-7) ndaj Belinda Bencic të Zvicrës. Më tej është kualifikuar edhe tenistja amerikane Coco

Gauff, numri 3 në botë, që mundi 2-0 (6-4, 6-2) Laylah Fernandez. Kualifikohen edhe spanjollja Paula Badosa, rusja Mirra Andreeva dhe rusja Anastasia Pavlyuchenkova.











## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

